

**Një përshkrim i vendimit të Panelit në rastet 2010-02; 2010-03; 2010-04; 2010-05 dhe 2010-06**

**Paneli njëzëri**

- *Shpall* se sipas Rregullit 25 të Rregullores së vet të Punës nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesat në lidhje me veprimet dhe mosveprimet nga UNMIK-u, dhe shpall ato ankesa **të papranueshme**;
  - Kjo do të thotë se Paneli mund të shqyrtoj vetëm shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Paneli nuk mund të shqyrtoj veprimet apo mosveprimet e UNMIK-ut.
  
- Sipas nenit 2 të Konventës, sa i përket veprimeve të EULEX-it rreth hetimit të veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve të burgut *shpall* ankesat **të papranueshme**;
  - Kjo do të thotë se pasi hetimi i veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve të burgut duhet të ishte kryer menjëherë pasi kishte ndodhur incidenti në vitin 2003, EULEX-i nuk ka pasur obligim që të filloj një hetim në vitin 2008. Gjithashtu EULEX-i nuk mund të rifilloj hetimin, përderisa hetimi nuk kishte filluar asnjëherë.
  
- Sipas nenit 2 të Konventës, *shpall të pranueshme* ankesat në lidhje me veprimet e EULEX-it rreth hetimit të burgosurve,
  - Kjo do të thotë se Paneli mund t'i hetoj veprimet e prokurorëve të EULEX-it para se rasti të sillet pranë një gjykate.
  
- *Konstaton* se lidhur me këtë **nuk ka pasur shkelje** të nenit 2 të Konventës nga ana e EULEX-it gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
  - Kjo do të thotë se edhe pse Paneli mund të shqyrtoj veprimet e prokurorit në këtë rast në lidhje me vendimin për të mos ndjekur penalisht të burgosurit, Paneli gjen se sa i përket kësaj, prokurori i EULEX-it ka bërë gjithçka që ka qenë e mundshme.

Kjo përmbledhje është një dokument i përpiluar nga Sekretariati i Panelit, me qëllim të vetëm për të dhënë sqarime dhe kjo nuk e obligon Panelin.

Vendimet, rekomandimet dhe njoftimet e tjera rreth Panelit mund t'i gjeni në: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu).